



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1585/1 Prot.

Tiranë, më 17 / 10 / 2019

V E N D I M

Nr. 147, Datë 17 / 10 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 85, datë 18.07.2019, të bërë nga N.D kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore¹”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “*Që prej vitit 2010 ka qenë i punësuar në pozicione të ndryshme pranë administratës tatimore dhe nuk ka pasur asnjë vërejtje me shkrim apo me gojë. Me shkresën nr. 70983/1, datë 30.11.2016, është emëruar Inspektor Zbatimi, kategoria e pagës IV-b, në Sektorin e Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë. Në pozicionet e punës që ka mbajtur, nuk ka pasur kritere të veçanta për degën e arsimimit. Me emërimin e Drejtorit të ri të përgjithshëm u krye ristrukturimi i Drejtorisë së Hetimit Tatimor, në të cilën ka ndryshuar vetëm emri i sektorit ku punonte, nga Sektori i Zbatimit në Sektori i Monitorimit Territorial, pa u ndryshuar numri i punonjësve. Me shkresën nr. 9587/1, datë 23.05.2019 është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, pasi nuk përmbushte kriteret e veçanta të pozicionit të punës, për shkak të profilit të arsimit edhe pse në rregulloren e rekrutimit, për pozicionin Inspektor, kategoria IV-b, përfshihen dhe shkencat ekzakte. Ankuesi deklaroi se në Sektorin e Monitorimit Territorial, vazhdojnë të punojnë, Inspektorë me shkollim, Shkenca Politike, Shoqërore, etj, të cilët nuk janë larguar nga puna, edhe pse nuk kanë pervojën e ankuesit prej 9 vitesh në sistemin tatimor. Ankuesi pretendon se ka pasur paramendim në largimin e tij nga puna, pasi është njoftuar për zhvillimin e takimit me punëdhënësin lidhur me ristrukturimin e*

¹ Referuar Diplomës nr. 6710, datë 14.02.1994 të Universitetit të Tiranës, ankuesi është diplomuar pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Dega Fizikë.

institucionit në datë 10.05.2019, ndërkohë që organigrama e re e institucionit ka dalë në datë 13.05.2019”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 85, datë 18.07.2019 të N.D u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1129/1, datë 24.07.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për ankesën e bërë nga N.D si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të procedurës së largimit nga detyra të punonjësit, N.D.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Kopje të detyrave të Sektorit të Zbatimit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë (sipas strukturës së vjetër).
- Kopje të përshkrimit të punës, kritereve të përgjithshme dhe të posaçme, për pozicionin e punës, Inspektor Zbatimi, kategoria e pagës IV-b, në Sektorin e Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë (sipas strukturës së vjetër).
- Kopje të detyrave të Sektorit të Monitorimit Territorial të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë (sipas strukturës së re).
- Kopje të përshkrimit të punës, kritereve të përgjithshme dhe të posaçme, për pozicionin e punës, Inspektor, kategoria e pagës IV-b, në Sektorin e Monitorimit Territorial, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë (sipas strukturës së re).
- Kopje të vendimit të Komisionit të Ristrukturimit të Administratës Tatimore për vlerësimin e punonjësve që do qëndronin në pozicionin e punës, Inspektor në Sektorin e Monitorimit Territorial, pas ndryshimit të strukturës.
- Kopje të vlerësimit të punës të punonjësit, N.D për vitet 2017 dhe 2018.
- Kopje të diplomës së arsimit të lartë për të gjithë punonjësit e Sektorit të Monitorimit Territorial, që janë në marrëdhënie pune.
- Kopje të Rregullores për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit, largimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor.
- Kopje të Urdhrit nr.171, datë 13.05.2019 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Me shkresën nr. 14615/1, datë 23.08.2019, DPT në mes të tjerash informoi se: *“Vendimmarrja e Titullarit të Institucionit shprehet nëpërmjet një akti administrativ individual dhe vjen si pasojë e shqyrtimit dhe analizës së përputhshmërisë të kritereve arsimore të përcaktuara në Rregulloren “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor”, e ndryshuar, si dhe të dhënave të dosjes personale. Në zbatim të kritereve arsimore për pozicionet e punës në strukturat e hetimit tatimor, të mirëpërcaktuara në rregulloren e sipërcituar dhe ndodhur edhe para faktit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH për Auditimin në DPT, njoftuar me shkresën Nr. 280/1, datë 21.11.2018, ku shprehimisht citohet: “Të merren masat për zbatimin e kritereve të posaçme të rregullores për procedurat e rekrutimit edhe për punonjësit e rekrutuar përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregullore dhe eliminimin e standardit të dyfishtë brenda administratës shtetërore”, si dhe në zbatim të Urdhërit nr. 86, datë 03.05.2019 të Kryeministrit, mbi ndryshimet strukturore, Punëdhënësi ka vendosur të zgjidhë kontratën e punës në respektim të procedurës dhe afateve të njoftimit, përcaktuar në dispozitat e Kodit të Punës”.*

- Me e-mail-et datë 30.08.2019 dhe 20.09.2019, subjekti ankues ka informuar se: *“Pas ndryshimit të rregullores “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor” në datë 14.05.2019, për pozicionin Inspektor, kategoria 4/b, janë pranuar punonjës me arsim, shkenca ekzakte, ndërkohë që atë e kanë larguar nga puna në datë*

28.05.2019 për shkak të arsimit”, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionerit, shkresën nr. 15445/1, datë 23.08.2019 të DPT si dhe përgjigjen e dërguar nga zyra e bashkëqeverisjes në datë 15.07.2019.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

N.D me Vendimin Nr. 1165, datë 26.03.2010 është emëruar përkohësisht, Specialist në Sektorin e Administratës në Drejtorinë e Financës, Administratës dhe Prokurimeve në DPT, deri në përfundim të zhvillimit të procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune. Me Vendimin nr. 634, datë 28.02.2013 është emëruar Inspektor i Dytë në Sektorin e Verifikimit në Terren në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, me kategorinë e pagës IV-a. Me Vendimin nr. 1270, datë 21.11.2016 është emëruar Inspektor Zbatimi në Sektorin e Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, në DRT Tiranë, me kategorinë e pagës IV-b. Me shkresën nr. 9587, datë 10.05.2019 është njoftuar për zhvillimin e takimit me punëdhënësin me qëllim bisedimin lidhur me ndryshimet strukturore, që mund të preknin dhe marrëdhënien e tij të punësimit me administratën tatimore. Me shkresën nr. 9587/1, datë 23.05.2019, DPT ka informuar ankuesin se, për shkak të ndryshimeve strukturore, reduktimit të numrit të pozicioneve të punës, ndryshimeve në emërtesa dhe riorganizimeve të strukturave të hetimit tatimor, krahasuar me strukturën dhe organikën e mëparshme, njoftoheni për zgjidhjen e kontratës së punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare. Ndërsa me shkresën nr. 27635/1, datë 28.05.2019, DRT Tiranë ka njoftuar ankuesin për zgjidhje të kontratës dhe ndërprerje të marrëdhënieve financiare, pasi nuk përmbush kriteret e veçanta të pozicionit të punës. Referuar Diplomës nr.6710, datë 14.02.1994, nr. Regjistri 8986 të Universitetit të Tiranës, N.D është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Natyrore, Dega Fizikë.

Referuar ndryshimeve strukturore dhe riorganizimit të strukturave të hetimit tatimor, rezulton se:

- Në Urdhërin nr.49, datë 27.02.2019, të Kryeministrit “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, numri i punonjësve në Sektorin e Zbatimit në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DRT Tiranë ishte 72 punonjës.
- Në Urdhërin nr.86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, të ndryshuar, numri i punonjësve në Sektorin e Monitorimit Territorial në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DRT Tiranë është 74 punonjës.
- Me Urdhërin nr.171, datë 13.05.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është bërë miratimi i organigramës i Administratës Tatimore Qendrore.

Në analizë të dokumenteve të vëna në dispozicion nga palët, lidhur me argumentin e DPT, se largimi i ankuesit nga puna kishte ardhur si rezultat i mospërbushjes së kriterit të veçantë të pozicionit të punës, rezulton se:

- Në nenin 5 të Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor” të miratuar me Urdhërin nr. 65, datë 04.10.2017 të Drejtorit të DPT, përcaktohet se: Kriteret e posaçme: Kandidatët të cilët konkurrojnë për praninë në strukturat e hetimit tatimor duhet të plotësojnë kriteret e posaçme sipas pozicionit për të cilin konkurrojnë: d. Spektori i Zbatimit - Inspektori Zbatimi IV-b- duhet të zotërojë minimalisht diplomë Bachelor në Shkenca Ekonomike ose Juridike.
- Në nenin 5 të Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit, largimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor” të miratuar me Urdhërin nr. 65/2, datë 14.05.2019 të Drejtorit të DPT, përcaktohet se: Kriteret e posaçme: Kandidatët të cilët konkurrojnë për praninë në strukturat e hetimit tatimor duhet të plotësojnë kriteret e posaçme sipas pozicionit për të cilin konkurrojnë: e. Spektori i Monitorimit Territorial - Inspektori Zbatimi në Spektorin e Monitorimit në Terren IV-b- duhet të zotërojë minimalisht diplomë Bachelor në Shkenca Ekonomike, Juridike, Shoqërore ose Ekzakte.

Bazuar në aktet e administruara nga Komisioneri rezulton se, me Vendimin nr. 1270, datë 21.11.2016, N.D është emëruar Inspektori Zbatimi në Spektorin e Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, në DRT Tiranë, me kategorinë e pagës IV-b. Theksojmë se në atë periudhë nuk ka patur parashikim ligjor, lidhur me kriterin e posaçëm mbi profilin e arsimit. Ndërkohë që vendosja e kriterëve të posaçme për pozicionin e punës që mbante N.D është parashikuar me miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor”, në datë 04.10.2017. Ndërkaq, Komisioneri vëren se, me shkresën nr. 27635/1, datë 28.05.2019 “Për zgjidhje të kontratës dhe ndërprerje të marrëdhënieve financiare”, ankuesi është larguar nga puna për shkak të se nuk përmbush kriteret e veçanta të pozicionit të punës, pothuaj 18 muaj pasi ishte miratuar rregullorja e sipërcituar.

Lidhur me argumentimin e DPT se largimi nga puna i ankuesit kishte ardhur si rezultat i ndryshimeve strukturore, i zbatimit të rekomandimeve të KLSH, njoftuar me shkresën Nr. 280/1, datë 21.11.2018, dhe mospërshtatjes së kriterit arsimor me pozicionin e punës, Komisioneri vlerëson se:

Së pari, struktura pararendëse e DPT është ndryshuar me Urdhërin nr.49, datë 27.02.2019, dhe nëse DPT donte të merrte masa për zbatimin e kriterëve të posaçme sipas rregullores së rekrutimit, ato mund të ishin reflektuar që me ndryshimin e strukturës, pas datës 27.02.2019, për më tepër që DPT ka qenë në dijeni të rekomandimeve të KLSH, që në datë 21.11.2018.

Së dyti, në Rregulloren e mëparshme “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor” të datës 04.10.2017, kriteri arsimor për pozicionin e N.D ishte, diplomë Bachelor në Shkenca

Ekonomike ose Juridike ndërsa në Rregulloren e re të miratuar në datë 14.05.2019, kriteri arsimor për pozicionin që mbulonte ankuesi u ndryshua në, diplomë Bachelor në Shkenca Ekonomike, Juridike, Shogërore ose Ekzakte, ndërkohë që ankuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare në datë 28.05.2019.

Komisioneri vlerëson se, arsyetimi i DPT se ankuesi ishte larguar nga detyra për shkak se nuk plotësonte kriteret e posaçme të profilit të arsimit, pasi ai ishte i diplomuar në shkenca ekzakte dhe në rregullore kërkohet diplomë në shkenca juridike ose ekonomike, nuk qëndron dhe është haptazi tendencioz, pasi kishte rreth 2 javë që ishte miratuar rregullorja e re dhe ankuesi plotësonte kriterin e posaçëm (diplomë Bachelor në Shkenca Ekzakte) për të punuar në pozicionin, Inspektor Zbatimi në Sektorin e Monitorimit në Terren IV-b.

Së treti, nga krahasimi i bërë ndërmjet strukturës së vjetër dhe asaj të re, Komisioneri konstaton se, sektori ku ka punuar ankuesi ka pësuar ndryshim, përse i takon numrit të punonjësve dhe konkretisht: - Në strukturën e miratuar me Urdhërin nr.49, datë 27.02.2019, të Kryeministrit, numri i punonjësve në Sektorin e Zbatimit në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DRT Tiranë ishte 72 punonjës, ndërsa në strukturën e miratuar me Urdhërin nr.86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit, numri i punonjësve në Sektorin e Monitorimit Territorial në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DRT Tiranë është 74 punonjës, pra është shtuar me dy numri i punonjësve në sektorin ku punonte ankuesi.

Së katërti, në analizë të diplomave të arsimit të lartë të punonjësve aktualë të Sektorit të Monitorimit, rezulton se janë së paku 4 punonjës të cilët zotërojnë diploma të cilat nuk plotësojnë kriterin e posaçëm sipas Rregullores së datës 04.10.2017 dhe nuk janë marrë masa për largimin e këtyre punonjësve nga puna, dhe pikërisht janë punonjësit: A.SH, diplomuar në shkenca politike, E.XH, diplomuar në inxhinieri agrare, E.Gj, diplomuar në informatikë dhe L.V, diplomuar në inxhinieri tekstile.

Në interpretim të dispozitave të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë*”, i ndryshuar³, punëdhënësi mund të zgjidh kontratën e punës në çdo kohë, por për këtë duhet të ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dhe argumenta që justifikojnë zgjidhjen e marrëdhëniesve të punës.

Për sa më lart, Komisioneri duke mos gjetur shkak të ligjshëm për zgjidhjen e marrëdhëniesve të punës së ankuesit nga ana e DPT, konstaton se ai është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë dhe se masa e marrë ndaj tij për largimin nga puna është e pajustificuar dhe e pa bazuar në prova.

Për sa më sipër kemi trajtim të padrejtë dhe të pabarabartë të subjektit ankues në raport me punonjësit e tjerë të cilët kanë qëndruar në punë në Sektorin e Monitorimit në Terren.

³ Neni 153, ku përcaktohet se: “1) Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara. 2) Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t’i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhëniesve të punës. 3) Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet”.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁴, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Po ashtu, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në nenin 9⁵ të tij “Ndalimi i diskriminimit”, e parashikon këtë shkak, si shkak për të cilin ky ligj ofron mbrojtje nga diskriminimi.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”, Komisioneri gjykon se “gjendja arsimore” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë nga LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova⁶ të cilat faktojnë se ai e mbart atë.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

⁴ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

⁵ Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

⁶ Ankuesi ka depozituar Diplomën e përfundimit të arsimit të lartë.

Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e DPT, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe trajtimit të pafavorshëm të tij.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore⁷, rezultoi se:

- Në Sektorin e Monitorimit Territorial në Drejtorinë e Hetimit Tatimor në DRT Tiranë, rezulton se janë të punësuar dhe 4 punonjës të tjerë të cilët zotërojnë diploma të cilat nuk plotësojnë kriterin e posaçëm, sipas Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor” të miratuar me Urdhërin nr. 65, datë 04.10.2017 të Drejtorit të DPT, dhe janë me arsim, shkenca shoqërore ose ekzakte.

Referuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nuk kemi trajtim të pafavorshëm të ankuesit për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e DPT, për faktin se ka dhe punonjës të tjerë të cilët nuk plotësojnë kriterin e posaçëm dhe vazhdojnë të jenë në marrëdhënie punësimi, dhe ky shkak nuk mund të qëndrojë si fakt për të provuar se diskriminimi i N.D ka ardhur si pasojë e gjendjes së tij arsimore.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë nga ana e DPT, por nuk u gjenden prova dhe fakte të vërtetojnë lidhjen objektive ndërmjet këtij trajtimi dhe shkakut të pretenduar nga ankuesi.

Referuar fakteve dhe provave të sipërcituara, nuk konstatohet të jenë përdorur praktika diskriminuese ndaj N.D, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për shkakun e pretenduar nga ankuesi, pasi nuk rezultoi të ekzistonte një lidhje shkakësore ndërmjet trajtimit të pafavorshëm dhe shkakut të pretenduar.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 7/1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se DPT nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankuesit, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të për shkak të gjendjes arsimore.

⁷ Referuar dokumentacionit të dërguar nga DPT me shkresën nr. 14615/1, datë 23.08.2019, lidhur me llojin e diplomave të 69 punonjësve të Sektorit të Monitorimit Territorial.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit N.D nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për shkak të gjendjes arsimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Robert GAJDA

KOMISIONER